



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2024:040552
Datë: 10.06.2024
Numri i dokumentit: 05803450

P.nr.2024:040552

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Lulzim Paçarizi, si dhe sekretaren juridike Behije Karaçica, në çështjen penale ndaj të akuzuarit B.T për shkak të veprës penale Shmangia nga tatimi nga neni 307 par.1 të KPRK-së, ndërsa sipas aktakuzës PP.nr.55/22 të dt.07.02.2024, pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar, të dt.05.06.2024, ku prezent ishin Prokuroria e shtetit Uridia Caka, i akuzuari B.T dhe përfaqësuesja e ATK-së M.G-Zh, me dt.07.06.2024, shpallë, ndërsa me dt.10.06.2024, e përpilon këtë:

A K T G J Y K I M

I AKUZUARI: B.T, nga i ati M dhe e ëma N e lindjes D, i lindur më datën data... në Rahovec, ku edhe banon në, me nr.personal:nr..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, i ati i 3 fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor, i gjendjes së mesme ekonomike.

Ë S H T Ë F A J T O R

Për shkak se nga viti 2018 gjer në fund të vitit 2019 në Rahovec, saktësisht në biznesin e tij individual "B.T", i pandehuri duke vepruar në cilësi të pronarit të biznesit, i shmanget tatimit dhe kontributeve të tjera që kërkohen me ligj, në atë mënyrë që gjatë kontrollit tatimor jep të dhëna të pavërteta për të ardhurat duke mos i përfshirë të ardhurat e deponuara në banka e po ashtu është konstatuar disproporcion në sasinë e stoqeve për periudhën vlerësuese tatimore, me ç' rast si pasojë shmangies së tatimit në të ardhura personale, tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatimit në kontribute pensionale, buxhetit të Republikës së Kosovës- Administratës Tatimore të Kosovës i ka shkaktuar dëm financiar në shumë prej 6.230.51 €.

- Me këto veprime ka kryer veprën penale Shmangia nga tatimi nga neni 307 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata konform nenit 4, 17, 39, 40, 42, 43, 44, 46, 69, e nenit 307 par.1 të KPRK-së si dhe nenit 364, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës të njëjtin e :

G J Y K O N

Me dënimin me gjobë në lartësi prej 300 € (treqind) euro, si dhe me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditëve, me kërkesën dhe pëlqimin e të akuzuarit, konform nenit 44 të KPRK-së dënimi me burgim i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumën prej 700 € (shtatëqind) euro.

Konform nenit 76 par.1 dhe 2 pika 2.4 të KPRK- gjykata e gjykon me **DËNIM UNIK**:

ME GJOBË në shumën prej 1000 (njëmijë) euro, dënimin e shqiptuar me gjobë do ta paguaj në afat prej 30 ditësh, pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, gjykata dënimin me gjobë do ta zëvendësoj me dënim burgu në kohëzgjatje prej 50 (pesëdhjete) ditësh, duke llogaritur çdo 20 (njëzet) euro për një ditë burgu.

Obligohet i akuzuari në emër të paushallit gjyqësor gjykatës t'ia paguajnë shumën prej 20 euro, për programin mbi kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20 euron ndërsa shpenzime te procedurës penale nuk ka pasur, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën ekzekutimi do të behet me detyrim.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP.nr.55/22 të dt.07.02.2024, e ka akuzuar B.T, për shkak të veprës penale shmangia nga tatimi nga neni 307 par.1 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor si dhe administrimit të provave, të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj në bazë të ligjit.

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me dt.05.06.2024, ku prezent kanë qenë, prokuroria e shtetit Uridia Caka, i akuzuari B.T si dhe përfaqësuesja e ATK-së M.G-Zh, andaj ka pasur kushte për mbajtjen e shqyrtimit fillestar.

I akuzuari B.T, deklarohet i fajshëm për veprën penale për të cilën ngarkohet, duke shtuar se me vije keq për rastin i cili ka ndodhur, po ashtu deklarojë se të dëmtuarës demin j kam paguar dhe nuk kam kurrfarë obligimi ndaj ATK-së, ky ka qenë rasti im i parë qe kam ra ndesh me ligjin, për të cilin jam penduar dhe kërkoj falje andaj kërkoj nga gjykata qe te merren parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese me rastin e shqiptimit të dënimit që të më shqiptohet një dënim sa më i butë, po ashtu i propozojë dhe i jap pëlqimin qe në rast eventual qe ne rast të shqiptimit të dënimit me burg të më zëvendësohet me dënim me gjobë

Përfaqësuesja e ATK-së ka deklaruar: Nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë, i bashkangjitem ndjekjes penale ndërsa sa i përket dëmit material të shkaktuar buxhetit

të ATK-së përkatësisht buxhetit të Kosovës, sipas raportit të kontrollit të inspektorëve tatimorë nr. dosjes 6077 i datës 07.12.2020 si dhe kallëzimit penal nr.97/21 i datës 31.12.2021 i ka shkaktuar dëm buxhetit të Kosovës përkatësisht ATK-së vlerën prej 2.320.91 euro të cilën vlerë i akuzuari e ka paguar dhe si dëshmi i ofrojë gjykatës dëshminë nga sistemi i ATK-së SIGTAS i datës 04.06.2024 ku dëshmohet se i akuzuari gjendjen e obligimeve e ka zero euro.

Prokurori i shtetit Uridia Caka në shqyrtimin fillestar ka deklaruar: Nuk e kundërshton pranimin e fajësisë të bërë nga i akuzuari meqenëse i njëjti pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyre vullnetare duke i ditur natyrën dhe pasojat e fajësisë, si dhe pranimi i fajësisë mbështetet në provat materiale dhe personale ne bazë të cilave është ngritur kjo aktakuzë e cila nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike andaj i propozojë gjykatës që ta aprovoje pranimin e fajësisë të bërë nga ana e të akuzuarit si dhe me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimi si rrethanë renduese të merre dashjen e tij në kryerjen e veprës penale si dhe lartësinë e demit që i ka shkaktuar buxhetit të Kosovës ndërsa sa i përket rrethanave lehtësuese ja lë në vlerësim gjykatës.

2. Vlerësimi i pranimin të fajësisë

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 242 të KPPRK-së. Gjatë pranimin të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoj se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar.

Duke u bazuar në këto që u ceken me lart gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

-se i akuzuari B.T nga pakujdesia ka kryer veprën penale shmangia nga tatimi nga neni 307 par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjendjen e këtillë faktike e mori në tërësi ashtu siç ishte përcaktuar në aktakuzë dhe në provat të cilat i përmbante aktakuza, e ato janë:

- Kërkesa për inicim penal numër DPVM:07/2021, datë 06.07.2021;
- Raporti i Kontrollit, datë 07.12.2020 i përpiluar nga Inspektoret Tatimorë;
- Shkresat/të dhënat lidhur me blerjet dhe importet e kompanisë;
- Pasqyra e tatimpaguesit me pronar të pandehurin, dt.24.12.2021;
- Transaksionet bankare;

- Ekspertiza financiare e punuar nga Dr.Sh.B, ekspertt financiar gjyqësor, e dt. 16.05.2022;
- Deklarata e të pandehurit B.T, e dhënë në prokurori me datë 02.02.2024;
- Si dhe shkresat tjera në lëndë.

4. Elementet e veprës penale.

Në nenin 307 par.1 të KPRK-së, është parashikuar se: *Kushdo që me qëllim që ai apo personi tjetër të fsheh apo t'i shmanget, pjesërisht apo tërësisht, pagesës së tatimit, apo kontributeve të tjera që kërkohen me ligj, apo i shmanget tatimit duke përfutuar rimbursimet tatimore apo kreditë tatimore të pajustificuara, jep të dhëna të pavërteta për të ardhurat apo nuk i përfshin të dhënat lidhur me të ardhurat e tij, , gjendjen ekonomike apo fakte të tjera, ose përndryshe ofron informata false relevante për vlerësimin e detyrimeve të tilla, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në katër (4) vjet.*

5 Vendimi i gjyqtarit të vetëm gjykues.

Duke u bazuar në këto që u ceken me lart gjyqtari i vetëm gjykues të akuzuarin B.T e ka shpallur fajtor për veprën penale për të cilën ngarkohet, nga se në veprimet e tij të përshkruara si në dispozitiv të aktgjykimit, formohen të gjitha elementet e veprës penale shmangia nga tatimi nga neni 307 par.1 të KPRK-së, për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta gjykoj në bazë të ligjit, e me parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 të KPRK-së (kodi nr. 06/L074), të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit, pranimin e fajësisë, për herë të parë ka ra ndesh me ligjin, i gjendjes së mesme ekonomike, mbajtës i familjes prej 5 anëtarësh, ka një biznes individual familjarë të cilin e mban me familje, të dëmtuarës ATK-së dëmin e shkaktuar ia ka paguar, premtimin se në të ardhmen nuk do te kryej kurrfarë vepre penale, ndërsa si rrethanë rënduese dashjen e tij për kryerjen e veprës penale dhe dëmin që i ka shkaktuar buxhetit të Kosovës, andaj gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin me gjobë në shume prej njëmijë euro (1000 €), mund të arrihen qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike

E dëmtuara ATK, nuk është udhëzuar në kontestin civil, pasi që e përfaqësuesja e të dëmtares nuk ka parashtruar kërkesë pasurore juridike.

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale.

Vendimi paushallin gjyqësor dhe shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 449 par.1 dhe 2 të KPPK-së, ndërsa vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marr konform nenit 39 parg.3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit nr.05/L036 për kompensimin e viktimave të krimit.

Me sa u tha me lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e konform nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr.2024:040552, me dt.07.06.2024.

Sekretarja juridike
Behije Karaçica

Gjyqtari i vetëm gjykues
Lulzim Paçarizi

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, nëpërmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.